



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202100760/2

Tiranë ___/___/2021

Lënda: *Rekomandohet përmirësimi i kushteve të trajtimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve në IEVP-në Fushë-Krujë.*

Drejtuar: **Z. Agim ISMAILI**
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

Z. Qazim HOXHA
Drejtor i IEVP-së Fushë-Krujë

FUSH-KRUJË

Të nderuar zotërinj,

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës (MKPT), në vijim Mekanizmi Kombëtar, seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, si dhe nenin 81 i ligjit 81/2020 "Për të drejtat e dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Fushë-Krujë.

Inspektimi u krye më datë 20.05.2021, sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z.Besnik Deda, znj.Nertila Qafzezi dhe z.Hazbi Selita, me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Objektivi kryesor i vizitës monitoruese në IEVP Fushë-Krujë ishte vlerësimi i kushteve për akomodimin dhe jetesën e të burgosurve, cilësia e trajtimit të burgosurve sipas të drejtave të garantuara në legjislacionin tonë dhe aktet ndërkombëtare, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, Avokati i Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar, ka detyrimin kushtetues e ligjor, t'ju parashtrorë gjetjet e këtij inspektimi dhe të bëjë rekomandimet përkatëse.

Shënime paraprake

Kjo ishte një vizitë periodike monitoruese e Mekanizmit Kombëtar pranë Avokatit të Popullit në IEVP Fushë-Krujë për vitin 2021. Grupi i inspektimit u takua fillimisht me drejtorin e institucionit z.Qazim Hoxha, shefin e policisë z.Nikolin Gjonpalaj, si dhe shefat e sektorit juridik, sektorit të çështjeve shoqërore, sektorit të logjistikës dhe sektorit të burimeve njerëzore, të cilët u vunë në dijeni të qëllimit të këtij inspektimi.

Gjatë takimit me drejtuesit e institucionit, grupi inspektues kërkoi fillimisht një informacion në lidhje me garantimin e të drejtave dhe trajtimin e të burgosurve në këtë institucion, kushtet për jetesë normale të krijuara në dhomat e banimit dhe ambientet e përbashkëta, si dhe verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të bëra nga institucioni i Avokatit të Popullit në inspektimet e mëparshme.

IEVP Fushë-Krujë është institucion relativisht i ri, i krijuar në korrik të vitit 2008. Në bazë të Urdhërit të Ministrit të Drejtësisë nr.381, datë 19.07.2019 "Për disa ndryshime në Urdhërin nr.8927/1, datë 27.09.2018 të Ministrit të Drejtësisë "*Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale*", IEVP Fushë-Krujë kategorizohet si burg i sigurisë së zakonshme, me një seksion siguri e zakonshme dhe një seksion paraburgimi.

Kapaciteti maksimal zyrtar i institucionit është **312 persona**. Në kohën e vizitës, në këtë institucion ndodheshin 371 persona të burgosur, pra me një mbipopullim prej **59** personash mbi kapacitetet. Ndarja sipas sektorëve në momentin e inspektimit ishte, 181 të dënuar siguria e zakonshme dhe 190 të paraburgosur, të ndarë në 2 godina banimi që ndodheshin në regjimin e brendshëm. Grupi i inspektimit, gjatë vizitës në të dy godinat, konstatoi se pavarësisht numrit të personave mbi kapacitetet, të gjithë të burgosurit flinin në shtrat me krevat dhe asnjëri prej tyre nuk flinte me dyshek në dysheme.

Situata e popullimit për periudhën e fundit 6-mujore ishte si më poshtë:

- Nëntor 2020 373 të burgosur
- Dhjetor 2020 373 të burgosur
- Janar 2021 367 të burgosur
- Shkurt 2021 375 të burgosur
- Mars 2021 382 të burgosur
- Prill 2021 381 të burgosur

Referuar statistikave mbi situatën e popullimit në raport me kapacitetin fizik të institucionit, rezulton se ka patur mbipopullim në masën 15% të kapacitetit përgjatë tërë periudhës 6-mujore. Ndërkohë që, drejtuesit e institucionit e justifikonin këtë me faktin se, nga viti i krijimi të kësaj IEVP-je ka ndryshuar edhe kapaciteti fizik i tij, duke përshtatur për banim ambiente të reja sipas sektorëve, si edhe duke shtuar shtretër në dhomat e banimit. Aktualisht, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga drejtuesit e IEVP-së, gjendja e kompletimit me krevatë dhe shtretër ishte godina "A" me 200 shtretër dhe godina "B" me 262 shtretër, pra në total IEVP Fushë-Krujë disponon 462 shtretër.

Në analizën paraprake të kësaj situatë, MKPT vlerëson se, si nga inspektimi por dhe për periudhën e lartpërmendur, në IEVP Fushë-Krujë ka patur dhe ka mbipopullim. Rritja e numrit të shtretërve nuk është tregues që përcakton kapacitetin fizik të institucionit, pasi

janë cënuar kushtet për jetesë normale të këtyre shtetasve. Konkretisht, në shumicën e dhomave ku ishin akomoduar 4 dhe 6 persona, hapësira dhe sipërfaqja e banimit nuk i përgjigjej parametrave teknik dhe jetësor që i takon çdo personi, sikurse është e miratuar në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, por edhe larg standardeve ndërkombëtare që synojmë të arrijmë për këtë qëllim.

Struktura dhe organika aktuale e Institucionit në përgjithësi ishte e kompletuar me stafin e administratës dhe të punonjësve të sigurisë. Mungesat në organikë konsistojnë: 1(një) përgjegjës i sektorit të logjistikës; 1(një) kartelist, 1(një) mjek dhe 1(një) infermier. Ndërkohë, struktura dhe organika e institucionit po përshtatej me strukturën dhe organikën e re të IEVP-së Fushë-Krujë, miratuar me Urdhër Nr.43 datë 25.03.2021 të Kryeministrit të RSH “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithëshme të Burgjeve dhe sistemit të institucioneve të varësisë së saj*”.

Përsa i takon grupmoshave të të burgosurve, në këtë institucion ishin 8 të paraburgosur të grupmoshës 18-21 vjeç. Të paraburgosurit e kësaj grupmoshe ishin të sistemuar në dy dhoma më vete, me të cilët zhvilloheshin programe aktiviteteve dhe trajtime psiko-social të veçanta nga specialistët e sektorit të çështjeve shoqërore.

Kategori të veçanta që trajtoheshin me prioritet nga personeli shëndetësor në IEVP Fushë-Krujë ishin 25 të burgosur me probleme të shëndetit mendor, 15 të sëmurë diabetik dhe 9 të burgosur që kishin probleme me përdorimin e substancave narkotike dhe trajtoheshin me “metadon”.

Në lidhje me situatën e emergjencës shëndetësore për shkak të COVID-19, institucioni kishte nën monitorim situatën. Nga raportimi i stafit shëndetësor të institucionit, rezultoi se në momentin e inspektimit, nuk kishte asnjë të burgosur dhe punonjës të institucionit, të infektuar nga virusi COVID-19.

Stafi dhe punonjësit e sigurisë që kryenin shërbim sipas sektorëve, zbatonin masat e parashikuara në protokollin shëndetësor të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për parandalimin e kësaj sëmundje infektive. Në hyrje të institucionit punonjësi i informacionit kryente nëpërmjet termometrit dixhital matjen e temperaturës, për punonjësit e institucionit, ashtu edhe për vizitorët. Këto veprime regjistroheshin në një regjistër të veçantë, që mbahej nga punonjësi i informacionit.

Ndërsa në ambientet e punës të stafit dhe në ambientet e koridoreve të sektorëve në regjimin e brendshëm, ishin të vendosur dezinfektantë për pastrimin e duarve. Të paraburgosurit që paraqiteshin në seanca gjyqësore pajiseshin me maska mbrojtëse nga institucioni, ndërsa ata që shkonin për vizita mjeksore në Spitalin e Krujës apo Spitalin e Burgjeve, pas kthimit në institucion, karantinoheshin për 14 ditë në ambientin e observimit, në bazë të urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

Një nga masat e rëndësishme për parandalimin e sëmundjes infektive, është mbajtja pastër dhe higjienizimi i ambienteve individuale dhe kolektive. Përsa i takon gjendjes së kushteve të higjienës dhe pastërtisë, kryesisht në dhomat e banimit me shumë persona, ambientin e observimit, spitalit dhe veçimit që ndodheshin në godinën “A”, ato nuk ishin në gjendje të mirë higjeno-sanitare dhe kishin lagështirë. Në këto kushte, ato përbënin risk si për shëndetin e të burgosurve, ashtu dhe për përhapjen e virusit COVID-19.

Nga monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të MKPT-së të lëna nga inspektimi i i datës 16.10.2019 në IEVP “Fushë Krujë”, rezultoi se:

1. Ishte realizuar rekomandimi për krijimin e SKV-së për akomodimin e personave me probleme të shëndetit mendor, të cilët mbaheshin nën mbikqyerje të vazhdueshme nga stafi shëndetësor, psiko-social dhe i sigurisë.
2. Ishte realizuar rekomandimi për plotësimin e vendit vakant të mjekut stomatolog me kohë të plotë, si dhe kompletimi i kabinetit dentar me materialet dhe instrumentet dentare.
3. Ishte realizuar rekomandimi, për plotësimin e vendit vakant të farmacistit me kohë të plotë, si dhe për funksionimin e skemës të furnizimit dhe rimbursimit të ilaçeve, sipas kontratës tre palëshë të institucionit me FSDKSH dhe depon farmaceutike.
4. Ishte realizuar rekomandimi, për ndarjen e të burgosurve të rritur nga ata të grup-moshës 18-21 vjeçar, duke sistemuar në dy dhoma më vete, si dhe me program aktivitetesh dhe këshillimi psiko-social të veçantë të organizuar nga sektori i çështjeve shoqërore.
5. Ishte realizuar rekomandimi, për ndarjen e regjimeve sipas rregullores duke shmangur kështu bashkëjetesën e të paraburgosurve me të dënuarit me vendim të formës së prerë.
6. Ishte realizuar rekomandimi, për ofrimin e shërbimit të lavanterisë nga institucioni për veshjet dhe rrobat personale për të paraburgosurit/dënuarit.

Ndërkohë, nuk kishin gjetur zbatim rekomandimet e mëposhtme:

1. Vijonte situata e mbipopullimit në këtë institucion, duke shkelur standardin e përcaktuar që çdo qeli të ofrojë minimalisht 4m² hapësirë jetike për person, pavarësisht nga fakti se institucioni për çdo të burgosur kishte siguruar krevat dhe komplete të përshtatëshme për fjetje.
2. Në ambientin e veçimit dhe të observimit, në mënyrë të përsëritur, grupi i inspektimit konstatoi persona të akomoduar për një kohë të gjatë në këto ambiente, të cilët nuk ishin subjekt i masave disiplinore apo ndonjë parashikimi tjetër ligjor.
3. Furnizimi me ujë i ambienteve të brendshme të institucionit, bëhej nga rrjeti i ujësjellësit dhe nga pusi, dhe pavarësisht kësaj situata nuk ishte përmirësuar, pasi furnizimi me ujë i dhomave dhe dusheve bëhej me orar 3 herë në ditë.
4. Nuk ishin parashikuar fonde për investime, me qëllim vënien në përdorim të sistemit qëndror për ngrohje/ftohje, ndaj në këto kushte për periudhën e ftohtë të vitit, ishin lejuar rezistencat elektrike për ngrohje.
5. Vijonte problematika e ndërprerjes të energjisë elektrike si rezultat i mbingarkesës dhe defekteve në rrjetin e brendshëm të institucionit, për shkak të mungesës së ndërtimit të një godine në regjimin e brendshëm, për lidhjen me linjën 20 KË.
6. Nuk ishte realizuar rekomandimi, për sigurimin e mjekut me kohë të plotë në këtë institucion, me qëllim që tu përgjigjet në kohë kërkesave të të burgosurve për vizita

mjekstore apo lëshimin e rekomandimeve për vizita mjekstore apo konsulta të specializuara pranë qendrave spitalore.

Trajtimi

Grupi i inspektimit kishte si objektiv mbledhjen e informacionit lidhur me trajtimin e të burgosurve, në identifikimin e rasteve të përdorimit të torturës, trajtimin degradues e diskriminues, përdorimit të forcës fizike përtej kufijve të parashikuar me akte normative apo të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, si dhe të rasteve të marrjes së masave disiplinore të veçimit nga aktivitetet e përbashkëta.

Lidhur me këtë fakt, nisur nga informacioni i drejtuesve dhe stafi i institucionit, si dhe nga intervistat konfidenciale të zhvilluara me të burgosurit, grupi i inspektimit nuk konstatoi asnjë rast torture apo përdorimi të tepruar të forcës nga ana e punonjësve të policisë së këtij institucioni ndaj të burgosurve.

Një nga problemet shqetësuese që kishte të bënte me keqtrajtimin dhe që duhet të evidentohet, kishte të bënte me konstatimin e grupit të inspektimit në ambientet e observimit dhe të veçimit, ku u gjendën persona të akomoduar në shkelje të procedurave të parashikuara në rregulloren e brendshme të burgjeve dhe përtej afateve të përcaktuara në aktet ligjore. Konkretisht, në sektorin e observimit ndodheshin 9 persona si hyrje të reja, në pritje për tu përshtatur dhe sistemuar në sektorët e regjimit të brendshëm, nga të cilët 2 persona kishin më shumë se 2 vjet që qëndronin në këtë ambient për arsye të mospërshtatjes në dhomë me të burgosurit e tjerë. Po kështu, në sektorin e veçimit nga 4 persona që ndodheshin në momentin e inspektimit, 2 të burgosur ishin me masë disiplinore, ndërsa 2 personat e tjerë kishin më shumë se 15 ditë, që qëndronin aty për arsye të konflikteve me bashkëvuajtësit e tjerë në regjimin e brendshëm.

Ky ndërrim destinacioni i ambienteve, bie në kundërshtim me kushtet dhe procedurat e pranimit në IEVP, përbën trajtim jo dinjitoz të të burgosurve që janë akomoduar për periudhë të gjatë kohore, si dhe i diferencon dhe i vetëpërrjashton ata nga aktiviteti ditor që zhvillohet me të burgosurit e tjerë, që ka për qëllim ri-integrimin e tyre. Në vlerësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit për këtë situatë, ambienti i observimit dhe ai i veçimit janë të destinuara për përdorim në afate kohore sa më të shkurtra dhe se vendosja në to duhet të bëhet vetëm me vendim të komisioneve respektive, Komisionit të Pritjes dhe Komisionit Disiplinor.

Parimi i përpjestueshmërisë kërkon të ruhet një ekuilibër ndërmjet kërkesave të çështjes, dhe zbatimit të standardeve ligjore të regjimit. Izolimi i tej zgjatur, mund të ketë pasoja shumë të dëmshëm për personat në fjalë. Në çdo rast, të gjitha format e hyrjes në institucion dhe të veçimit duhet të jenë në afate sa më të shkurtra që është e mundur, por jo më shumë se 15 ditë.

Edhe në rastin kur një regjim i tillë imponohet ose zbatohet me kërkesë nga vetë i dënuari për arsye mospërshtatje, një garanci thelbësore është prezenca e vazhdueshme e mjekut në ambientet e veçimit dhe të observimit, me synimin që personeli mjekësor të kryejë vëzhgimin dhe ekzaminimin mjekësor të të burgosurve në mënyrë të vazhdueshme. Rezultatet e këtyre ekzaminimeve, përfshirë këtu një përshkrim të gjendjes fizike dhe mendore, si dhe pasojat e parashikueshme të izolimit të vazhduar, duhet t'u paraqiten rregullisht me anë të një deklaratë me shkrim nga ana e mjekut, autoriteteve kompetente

për çështjet e regjimit dhe sigurisë në IEVP. Në kushtet kur, në IEVP Fushë-Krujë ka mungesë organike të mjekut (qoftë me kohë të plotë dhe të pjesëshme) për një periudhë më shumë se një muaj dhe kjo praktikë nuk zhvillohet, përbën premisë për cenime të rënda në shëndetin fizik dhe mendor të këtyre personave.

Sikurse e theksuam edhe më lart, një problem tjetër i evidentuar nga grupi i inspektimit, ishte mbipopullimi në dhomat e banimit (4- 6 persona në një dhomë), si dhe tejkalimi i normës prej 4m² hapësirë jetike për person, e cila konsiderohet shkelje e standardit të sipërfaqes së banimit që duhet të disponojë një person i burgosur.¹ Shkelja e këtij standardi është evidentuar edhe nga Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT) me rastin e vizitave monitoruese në Shqipëri, i cili në përfundim të vizitës ka rekomanduar autoriteteve Shqiptare se: *“Të dënuarit/ paraburgosurit të akomodohen në dhoma jo me pak se 22 m² në rastet kur vendosen 6 veta në dhomë dhe 10m² në rastet kur vendosen 2 veta në dhomë. Gjithashtu, dhomat më të vogla se 6m² nuk plotësojnë standardet minimale për një dhomë burgu dhe duhet të nxirren jashtë shërbimi”*.

Nga intervistat konfidenciale të zhvilluara me të paraburgosurit dhe të dënuarit, rezultoi se kishte disa ankesa që ishin të lidhura kryesisht me kushtet e përgjithshme të jetesës në institucion. Ato konsistonin në prezencën e lagështirës në disa dhoma banimi dhe kryesisht në ambientet e përbashkëta si në tualete dhe dushe; problemet me sistemin elektrik dhe mungesën e sistemit qendror për ngrohje/ftohje, për t’iu përshtatur kushteve klimaterike; mungesën e ujit të ngrohtë për larjen e trupit; etj.

Një grup ankesash, kishin të bënin edhe me mungesën e takimeve fizike me familjarët, si dhe mungesën e aktiviteteve rekreative me karakter kulturor dhe sportiv me pjesmarrje të gjerë të të burgosurve, për shkak të zbatimit të protokollit shëndetësor të COVID-19. Gjithashtu, një kërkesë specifike e tyre ishte dhe angazhimi në kurse profesionale të organizuara nga QFP (Qendra e Formimit Profesional) Krujë në bashkëpunim me institucionin.

Ankesa u paraqitën dhe për mungesën e larmishmërisë dhe cilësinë e ushqimit, duke sjellë për pasojë që ushqimi që gatuhej nga kuzhina e institucionit të mos konsumohej prej të burgosurve.

Lidhur me kushtet e jetesës në dhomat e banimit, u konstatua se pastërtia dhe higjienizimi i ambienteve, nuk ishin të një cilësie të mirë. Grupi i inspektimit, konstatoi parregullsi dhe mungesë pastërtie në dhomat e banimit, në ambientet e dusheve dhe në ambientet e përbashkëta.

Masat mbrojtëse

Në përputhje me standardet e përgjithshme të inspektimit, grupi i monitorimit u njoh dhe administroi kopje të dokumentacionit ku ishin të evidentuara praktikatat e punës sipas sektorëve, me qëllim vlerësimin e kushteve dhe trajtimin e personave të dënuar dhe të paraburgosur.

¹ Neni 3 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe neni 30 e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

Ekspertët fillimisht morën informacion në lidhje me procedurat e ndjekura për pritjen e të burgosurve në institucion, si dhe funksionimin e Komisionit të Pritjes. Nga intervista e zhvilluar me drejtuesin e institucionit, si dhe nga verifikimi i dokumentacionit grupi i inspektimit konstatoi se, procedura e pranimit në institucion zbatohet në mënyrë korrekte dhe regjistrat e dosjet personale të të burgosurve ishin plotësuar sipas rubrikave.

Vëmendje e veçantë iu kushtua mënyrës si funksiononte sistemi i kërkesë/ankesave. Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacioneve, rezultoi se kërkesat dhe ankesat e të paraburgosurve ishin të regjistruara në regjistrin përkatës dhe ishin të protokolluara². Regjistrat mbaheshin nga sekretaria e institucionit.

Të burgosurit pasi plotësonin një formular kërkesë/ankese e dorëzonin më pas te punonjësit e sektorit psiko-social. Punonjësi i sektorit psiko-social i dërgonte formularët në sekretarinë e institucionit ku protokolloheshin dhe pastaj i kalonin drejtorit të institucionit. Në varësi të natyrës të kërkesë/ankesës, sektori përgjegjës i ngarkuar nga drejtori i institucionit i kthente përgjigje me shkrim, ose drejtori/punonjësit e institucionit zhvillonin takime me të burgosurit sipas rastit brenda afatit 3(tre) ditor. Në regjimin e brendshëm kishte edhe kuti postare ku mund të depozitoheshin ankesat/kërkesat, për korrespondencat që i drejtoheshin institucioneve të tjera. Gjatë vitit 2021 ishin evidentuar në regjistër gjithsej 51 kërkesë/ankesa nga të burgosurit.

Sipas shënimeve në regjistër, objekti i kërkesave kishte të bënte me kërkesa për takime me familjarë, kërkesë për takim me avokatë, vizita në spital, punësim ose kërkesë për blerjen e pajisjeve si TV, frigorifer, etj.

Ambientet e takimeve fizike me familjarët ishin të ndara më vete për të dënuarit dhe për të paraburgosurit. Në secilin ambient kishte 3 dhoma për takime fizike me familjarët, 3 dhoma për takime me avokatët mbrojtës dhe prokurorët, 2 dhoma për takime speciale dhe 1 dhomë për prindërim në distancë. Aktualisht, takimet me familjarët zhvilloheshin online, në 3 kompjuterat e vendosur në këto ambiente. Ambientet e takimeve kishin probleme me lagështirën. Të burgosurit zhvillonin 4 takime online në muaj me familjarët e tyre, në mungesë të 4 takimeve fizike për shkak të kufizimeve të pandemisë³, sipas përcaktimeve në rregulloren e brendshme të burgjeve.

Aparatet e telefonave me kartë, ishin të instaluar në korridoret e secilit prej seksioneve në regjimin e brendshëm. Aparatet e telefonave ishin në gjendje pune dhe nga intervistat me të burgosurit, deklaruan se flisnin me familjarët e tyre rregullisht 2 herë në javë. Por, të burgosurit kërkonin që të shtoheshin aparatet e telefonit në seksione, pasi nga dy kompani telefonike që operonin në sistemin e burgjeve, aktualisht është vetëm një kompani, gjë e cila ka sjellë si pasojë që të ulen minutat e bisedës (çmimi i kartës i njëjtë) dhe rreth 50% e aparateve telefonik të jenë të bllokuar dhe nuk funksionojnë.

² Neni 58 i ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".

³ Rifillimi i lejimit të takimeve të të dënuarve me familjarët filloi të aplikohet pas datës 14 Qershor 2021, me një takim në muaj duke respektuar distancën e sigurisë, kontrollin shëndetësor, ku familjari është i detyruar të paraqesë vërtetimin e vaksinimit, ose dokumentin e testit se nuk është i infektuar me Covid, apo teste të tjera serologjike që tregojnë se e kanë kaluar situatën e Covidit.

Grupi i inspektimit konstatoi gjithashtu se, numri i kontaktit me telefon me Avokatin e Popullit, nuk funksiononte pa tarifë shtesë për të burgosurit dhe jashtë listës prej 10 numrash të miratuar për të komunikuar me familjarët e tyre, sikurse përcaktohet në ligjin nr.81/2020. Ky shqetësim është ngritur nga të burgosurit dhe në IEVP-të e tjera.

Kategoria e grupmoshës së të paraburgosurve 18-21 vjeçare, ishin të sistemuar në dy dhoma më vete dhe zhvillonin aktivitete të përbashkëta sipas programit të miratuar nga sektori i çështjeve shoqërore. Nga intervistat e zhvilluara me të burgosurit e kësaj grupmoshe, grupi i inspektimit evidentoi disa ankesa në lidhje me mungesën e takimeve fizike me familjarët e tyre dhe mungesën e aktiviteteve me pjesmarrjen e gjerë të të burgosurve.

Në organikën e IEVP Fushë-Krujë kishte të burgosur të punësuar që punonin kryesisht si pastrues, sanitarë, shpërndarës ushqimi, berber etj. Nga intervistat e zhvilluara me të punësuarit, ata nuk kishte pretendime për kushtet e punës, por për mungesën e rregullave për punësimin dhe të shpërblimit për punën e kryer.

Punësimi i të burgosurve dhe shpërblimi për punën e kryer, rregullohet sipas neneve 43 dhe 44 të ligjit nr.81/2020 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*. Në nenin 43 të ligjit të sipërcituar ndërmjet të tjerave parashikohet se, *“Rregullat e posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës dhe kohëzgjatja e saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”*, ndërsa në nenin 44 të këtij ligji parashikohet dhe e drejta e një shpërblimi mujor për punën e kryer, ku thuhet shprehimisht se, *“Shpërblimi për secilën kategori caktohet në vlerë të drejtë në proporcion me sasinë dhe cilësinë e punës së kryer dhe organizimin e punës që rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave”*.

Pavarësisht tejkalimit të afateve të parashikuara në nenin 91 të ligjit nr.81/2020⁴, sikurse jemi bërë të njohur Këshilli i Ministrave në mbledhjen e datës 13.10.2021 ka miratuar Vendimin *“Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj”*, e cila në vlerësimin e Avokatit të Popullit, përbën një risi për garantimin e të drejtës të punës të të burgosurve në sistemin penitenciar.

Sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi ishte funksional. Në IEVP Fushë-Krujë, kamerat monitoronin pjesën më të madhe të mjediseve për 24 orë, ndërkohë që të dhënat ruheshin në server për një periudhë 30 ditore.

Kushtet materiale

Grupi i monitorimit, kishte në fokus të vizitës inspektuese plotësimin e kushteve materiale, si një prej elementeve shumë të rëndësishme të respektimit të standardeve të jetesës për të burgosurit.

Në përgjithësi, kushtet e jetesës dhe infrastruktura e përgjithshme e institucionit, ishin në gjendje të mirë me ndarje të rregullta të godinave, të cilat ofronin funksionalitet në

⁴ Parashikohet miratimi nga KM i akteve nënligjore brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e ligjit nr.81/2020. Në momentin e inspektimit po përgatitej drafti, i cili u miratua në datë 13.10.2021.

zhvillimin e programit të veprimeve sipas orarit ditor të të burgosurve, si dhe në elementët e sigurisë.

Në IEVP Fushë-Krujë gjendja teknike e godinave të banimit në regjimin e brendshëm, ishte në përgjithësi e mirë, por në disa ambiente si në dhomat e banimit, dhomat e veçimit e të observimit, dhomat e spitalit, tualetet dhe dushet e përbashkëta në çdo sektorë, ishte prezente lagështira. Muret e brendshme të këtyre ambienteve, ishin të dëmtuar nga prania e lagështirës, si dhe ndjehej era e rëndë e mykut. Sipas informacionit të drejtuesve të institucionit, shkak i lagështirës ishte se tarracat e godinave të banimit kishin nevojë për izolim dhe për rikonstruksione të ambienteve të brendshme. Nga ana e IEVP Fushë-Krujë ishin dërguar kërkesat me nevojat për investime drejtuar DPB, por ende nuk ishin siguruar fonde nga buxheti i shtetit për hidroizolimim e tarracave të godinave. Prezenca e lagështirës në këto ambiente, dëmton rëndë shëndetin e personave që qëndronin aty, qoftë dhe për një periudhë të caktuar kohore.

Baza materiale për akomodimin e të burgosurve dhe për jetesë normale, ishte e plotësuar. Në çdo dhomë banimi ishin të siguruar kompletimi me krevat, dyshekë, batanie e jastek dhe nga inspektimi nuk rezultoi të kishte asnjë person që flinte me dyshekë në tokë. Nga intervistat me të burgosurit, u evidentua fakti se pavarësisht se baza materiale përgjithësisht ishte e plotësuar, kishte të burgosur që deklarorin se bataniet dhe çarçafët i siguronin nga familjarët e tyre.

Sikurse përmendëm dhe më lart, kubatura dhe sipërfaqet e dhomave të banimit ishin të vogla, në raport me numrin e personave të akomoduar në secilën prej tyre. Në disa dhoma ishin akomoduar nga 4-6 persona. Dhomat ishin të pajisura me orënditë e nevojshme si tavolinë, karrige dhe komodina, por orënditë ishin të pamjaftueshme, pasi për një pjesë të sendeve personale dhe ushqimeve, të burgosurit i mbanin ato në qeska të vendosura në dysheme. Brenda ambientit të dhomave të banimit, ndodheshin tualetet të plotësuar me nyje hidrosanitare dhe furnizoheshin me ujë sipas grafikut të miratuar nga drejtuesit e institucionit, për mbajtjen pastër të higjienës personale dhe ambientit të dhomave. Dyert e tualeteve në shumicën e tyre, ishin të thyera dhe të dëmtuara, dhe në vend të tyre të burgosurit kishin vendosur mjete rrethore.

Niveli i ajrit dhe dritës natyrale në dhoma ishin të mjaftueshme, pasi dritaret ishin me përmasa të tilla që lejonin hyrjen e dritës dhe të ajrit natyral. Ndërkohë, ambientet në regjimin e brendshëm kishin edhe ndriçim artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik, i cili për shkak të mbingarkesës së linjës, herë pas here paraqiste probleme dhe difekte të shpeshta në sistemin elektrik. Veç mbingarkesës së linjave, shqetësuese ishte dhe gjendja e amortizuar e instalimeve elektrike në dhomat e banimit, në tualete dhe dushet e përbashkëta, ku dalloheshin qartë kabllot elektrik të zbuluar në dysheme dhe në mure, duke përbërë rrezik për sigurinë e jetës së të burgosurve.

Gjithashtu, grupi i inspektimit konstatoi si problematikë edhe mungesën e ngrohjes me kaldajë qëndrore të ambienteve të brendshme të institucionit. Kaldaja e këtij institucioni është montuar që në vitin 2008, dhe që prej asaj kohe ajo nuk është venë në shfrytëzim asnjëherë. Sipas informacioneve, mosfunksionimi i kaldajës qëndrore vjen për shkak se është i dëmtuar sistemi i trasmentimit për në regjimin e brendshëm. Në këto kushte, për periudhën e ftohtë institucioni kishte marrë masa për lejimin e hyrjeve të rezistencave elektrike për ngrohje, në dhomat e banimit.

Nga drejtuesit e IEVP Fushë-Krujë, lidhur me këto problematika, ishin drejtuar me informacione dhe shkresa zyrtare DPB (me preventivat për këto investime), ku kërkohej kryerja e investimeve për përmirësimin e rrjetit elektrik të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe riparimin e kaldajës qëndrore, por efektivisht edhe për buxhetin e vitit 2021, nuk ishin siguruar fondet për kryerjen e këtyre investimeve⁵. Kjo situatë u evidentua në vend nga grupi i inspektimit, si dhe dokumentacioni i administruar prej tij, gjatë vizitës inspektuese.

Kushtet në dhomat e banimit, kompletimi me orenditë e nevojshme për fjetje, plotësimi i nevojave të të burgosurve për ndriçim dhe ngrohje/ftohje, përbëjnë kushtet bazë për jetesë normale dhe strehim adekuat, sipas standardeve që përcaktohen edhe në Rregulloren e Evropiane të Burgjeve ku thuhet se: *“Strehimi që u ofrohet të burgosurve dhe në veçanti fjetja respektojnë dinjitetin njerëzor, dhe, sa më shumë të jetë e mundur, privacinë si dhe plotësojnë kërkesat shëndetësore dhe higjienike, duke u kushtuar rëndësinë e duhur kushteve të klimës dhe veçanërisht hapsirës së dyshemesë, përmbajtjes kubike të ajrit, ndriçimit, ngrohjes dhe ajrimit”*⁶.

Gjithashtu, gjatë vizitës në dhomat e të burgosurve dhe nga intervistat me të burgosurit, u konstatua se kishte mungesë të ujit të rrjedhshëm, i cili ishte me orar të reduktuar me grafik, tre herë në ditë nga 30 min. Grupi i inspektimit monitoroi në vend ambientet e përbashkëta të dusheve. Edhe pse ambientet dhe pajisjet e dusheve ishin në përgjithësi të pastra nga ana higjieno sanitare, nisur nga intervistat me të burgosurit, si edhe nga konstatimi në vend i gjendjes në të cilën ndodheshin këto ambiente, u arrit në konkluzionin se ato nuk funksiononin rregullisht për arsye të mungesës së ujit të rrjedhshëm dhe mosfunksionimit të sistemit qendror të ngrohjes në këtë IEVP. Ngrohja e ujit të dusheve kryhej me bolier me ngrohje elektrike, të cilët ishin vendosur të rinj, por kapaciteti i tyre nuk i përballonte kërkesat e të burgosurve për larjen e trupit. Për këtë arsye të burgosurit ishin detyruar që ujin ta ngrohnin me rezistenca primitive dhe shumë të rrezikshme për jetën, të cilat shkaktonin gjithashtu mbingarkesë dhe rënie të automateve të rrjetit.

Furnizimi me grafik me uje të rrjedhshëm i ambienteve të regjimit të brendshëm gjatë 24 orëve dhe mungesa e larjes së trupit nga të burgosurit sipas nevojave, mund të shërbejnë si premisë për mosrespektimin e higjienës personale të të burgosurve dhe si rrjedhojë nuk plotësojnë kërkesat e Rregullave Minimale të Trajtimit të të Burgosurve⁷, ashtu si edhe kërkesat e Rregullave Evropiane të Burgjeve ku midis të tjerave thuhet shprehimisht se: *“Çdo të burgosuri duhet t’i sigurohen kushte të përshtatshme në mënyrë të tillë që të bëjë dush, me ujë në temperaturë të përshtatshme me klimën. Kur është e mundur dushi mund të bëhet çdo ditë ose të paktën dy herë në javë (ose më shpesh nëse është e nevojshme) në interes të higjienës së përgjithshme”*⁸.

Lavanderia ishte në gjendje funksionale, por pjesa më e madhe e të burgosurve nuk pranonin të lanin rrobat e tyre. Ato vazhdonin të laheshin nga familjarët ose nga vetë të dënuarit brenda ambienteve të tyre. Në lavanderi laheshin vetëm materialet për fjetje si batanie dhe çarçafë. Për sa i përket furnizimit të të burgosurve me produkte të higjienës së përbashkët dhe asaj personale si detergjente, qese plehrash, shampo, e artikuj të tjerë, institucioni i kishte furnizuar ata sipas normativave çdo muaj. Të burgosurit, nga intervistat e tyre deklarorin se normativa mujore ishte e pamjaftueshme, dhe në këto

⁵ Shkresë nr.4261 prot., datë 07.11.2019 dhe shkresë nr.3018 prot., datë 02.12.2020 drejtuar DPB.

⁶ Rregulla 18.1 e Regullave Evropiane të Burgjeve

⁷ Rregulla 12 Rregullave Minimale të Trajtimit të të Burgosurve (ERM, Mandela Rules)

⁸ Rregulla 19 e Regullave Evropiane të Burgjeve

kushte i blinin te njësia tregtare ose i siguronin nga familjarët e tyre. Në ambientet e banimit dhe ambientet e përbashkëta, nuk vihej re prezencë e insekteve dhe brejtësve, e rezultonte që institucioni kishte marra masa për dezinfektimin e tyre.

Grupi i inspektimit gjatë vizitës në I EVP Fushë- Krujë, vuri re se kuzhina e institucionit kishte ambiente me hapsirë të bollshme, si dhe ishte e pastër dhe e rregullt. Stafi përbëhej nga 4 guzhiner dhe 7 nd/guzhiner të punësuar nga institucioni, të cilët ishin të pajisur me librezë shëndetësore. Menyja e përditshme ishte e afishuar, ndërsa kampionët e ushqimit ruheshin në kushte frigoriferike. Gatimi i ushqimit ishte sipas menysë të afishuar dhe normativës, ndarë më vete për të burgosurit, për të sëmurët me diabet dhe për të burgosurit e punësuar. Sistemi i sobave të gatimit dhe ai i aspirimit ishte funksional. Produktet ushqimore dhe ato të mishit, ruheshin në kushte frigoriferike, të ndara në frigoriferë më vete. Shpërndarja e ushqimit nga kuzhina në secilin prej sektorëve kryhej me karrocë dhe nga njëri kat i godinës në tjetrin me krahë. Grupi i inspektimit evidentoi faktin se godinat nuk kishin ashensorë të brendshëm dhe enët e kuzhinës që shërbenin për ndarjen e ushqimit, ishin të vjetëruara. Regjistrat e kontrollit të ushqimit dhe të menisë së gatimit ishin të plotësuar sipas rubrikave, të sekretuar dhe të protokolluar.

Ruajtja e ushqimit kryhej në ambiente të veçanta nga ambienti i gatimit, të cilat kishin hapsirë e nevojshme, me dritë dhe ajrim natyral. Ndërsa, produktet e bulmetit dhe të mishit ruheshin në kushte frigoriferike më vete.

Regjimi dhe aktivitetet

Grupi i inspeksionit u informua lidhur me respektimin e të drejtës të të burgosurve për të patur kontakte me familjarët, në kushtet e masave kufizuese për shkak të COVID-19. Aktualisht, në ambientin e takimeve ishin instaluar 3 kompjutera për lidhje me skype të të burgosurve me familjarët e tyre. Biseda online zgjaste deri në 15min, për shkak dhe të fluksit të kërkesave për takim të të burgosurve. Grafiku i takimeve me familjarët, firmosej çdo ditë nga drejtori i institucionit. Çdo i burgosur realizonte 4 takime me skype me familjen e tij/në muaj, si dhe kryente 8 biseda telefonike me familjarët/në muaj, sipas përcaktimeve në Rregulloren e Përgjithshme të Burjeve.

Takimet online me familjarët ishin të miratuara nga drejtori dhe shefi i policisë të institucionit, dhe zhvilloheshin sipas orarit të veprimeve, kryesisht vetëm gjatë orëve të paradites. Ndërsa bisedat telefonike, zhvilloheshin gjatë paradites dhe në oraret e mbasdites, sipas kushteve dhe mundësive të familjarëve të të burgosurve.

Institucioni kishte bibliotekë të veçantë për sektorin e të dënuarve dhe për sektorin e të paraburgosurve. Ato nuk ishin funksionale pasi kishin një numër të kufizuar me libra dhe nuk i përmbushin të gjitha kërkesat për lexim të të burgosurve. Gjithashtu, kërkesat për leximin e librave ishin të reduktuara vitet e fundit. Të paraburgosurit dhe të dënuarit që kërkonin t'u ofrohej ky shërbim, pasi regjistroheshin nga punonjësi i bibliotekës, ju hapej një kartelë personale dhe nëpërmjet saj tërhiqnin dhe dorëzonin librat sipas kërkesave.

E drejta e besimit respektohej dhe në institucion kishte hapësira të veçanta për ushtrimin e fesë, e cila realizohej në ditët e caktuara. Aktivitete fetare ofroheshin nga komuniteti mysliman shqiptar dhe shoqata kristiane e të burgosurve shqiptar. Për shkak të masave anti COVID-19, edhe organizimi i riteve fetare nuk ishte zhvilluar rregullisht, me

përfundim të muajit të Ramazanit, që institucioni kishte lejuar dhe programuar disa aktivitete.

Aktivitete me karakter kulturor dhe sportive gjithashtu, nuk ishin lejuar të zhvilloheshin për arsye të zbatimit të masave të parashikuara në protokollin shëndetësor të emergjencës shëndetësore, gjatë vitit të fundit. Të vetmet aktivitete që nuk ishin ndërprerë ishin orari i ajrimit, si dhe organizimi i lojrave me grupe të vogla.

Në lidhje me orarin e ajrimit gjatë muajve të verës nuk kishte ankesa nga të burgosurit, ndërsa në stinën e dimrit, me vendosjen e orarit të ri të ajrimit të reduktuar, shumica e të paraburgosurve dhe të dënuarve ishin të pakënaqur. Të burgosurit e intervistuar ngritën si ankesë, kthimin në normalitet dhe zhvillimin e sa më shumë aktiviteteve kulturore dhe sportive me pjesëmarrjen e gjerë të të burgosurve. Ndërkohë, sipas stafit të institucionit, të paraburgosurit dhe të dënuarit regjistroheshin në disa aktivitete, por jo gjithmonë i frekuentonin ato.

Spektori i edukimit kishte në organikë 9 punonjës, 1(një) përgjegjës sektori dhe 8(tetë) specialist me profesion psikolog dhe punonjës social. Nga verifikimi i dokumentacionit të këtij sektori, u evidentua se kishin programe për aktivitete të ndryshme mujore, si dhe për festa të veçanta, kryesisht për organizimin e festave fetare, sipas besimit të të burgosurve. Gjithashtu, dosjet personale të të burgosurve ishin të plotësuara rregullisht dhe konform rubrikave, me përmbledhjet nga takimet e fundit me të dënuarit dhe të paraburgosurit, me programet individuale dhe në grup, me vlerësimet e tre mujoreve dhe gjithë dokumentet e tjera mbështetëse, sipas llojit të asistencës së ofruar psikologjike, sociale apo mjekësore. Në dosje ishin të evidentuara edhe niveli i riskut sipas gjendjes psiko-emocionale që paraqiste çdo i burgosur, si dhe kohëzgjatja e trajtimit në varësi të qëndrueshmërisë së mendimeve dhe sjelljeve që ata reflektonin gjatë kohës të qëndrimit në këtë institucion.

U evidentua gjithashtu se, veç mungesës të aktiviteteve kulturore-sportive masive, kryesisht në periudhën e pandemisë, në IEVP “Fushë Krujë” mungonin edhe kurset profesionale të organizuara në bashkëpunim me Qendrën e Formimit Profesional Krujë, të cilat do të kishin një ndikim të madh në formimin profesional të të burgosurve, kalimin e kohës së lirë, si dhe ndër faktorët kryesor për rehabilitimin e tyre.

Shërbimi shëndetësor

Në IEVP Fushë-Krujë, organika sektorit shëndetësor nuk ishte e plotësuar. Ajo përbëhej nga mjeku, stomatologu, farmacisti dhe 5 infermjerë. Aktualisht, mungonte mjeku dhe një infermjerë. Nga informacioni i drejtorit të institucionit, edhe mjeku specialist që kishte lidhur kontratën me institucionin për të punuar me kohe të pjesëshme, kishte më shumë se një muaj që ishte larguar dhe akoma nuk ishte zëvendësuar me mjek tjetër. Shërbimet e tjera shëndetësore ndaj të burgosurve nuk ishin ndërprerë në asnjë moment.

Mungesa e mjekut të institucionit, shkakton në mënyrë të drejtpërdrejtë shkeljen e së drejtës për qasje deri te mjeku nga ana e personave të dënuar apo të paraburgosur, rast ky i cili është interpretuar dhe në qëndrimet e KPT⁹, ku parashikohet se: *“Derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet tu mundësohet qasja deri te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre” dhe se “shërbimi shëndetësor duhet*

⁹ Komiteti për Parandalimin e Torturës

të organizohet në atë mënyrë, që do të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme”.

Kjo nevojë bëhet edhe më emergjente në rastet e krizave shëndetësore si kjo aktualja, ku të burgosurit duhet ti nënshtrohen karantinës së detyrueshme, pas kthimit nga konsultat mjeksore pranë mjekëve në spitalet rajonale. Periudha 14 ditore e karantinës për të sëmurët kronikë që kryejnë vizitat mjeksore sipas rekomandimeve të mjekut është e gjatë, ndaj në këto situata emergjencash krahas kufizimeve, nxjerr nevojën e domosdoshme të rishikimit edhe të praktikave ligjore në dhënien e masave disiplinore ndaj të burgosurve.

Nga drejtuesit i institucionit, u theksua se shërbimi shëndetësor ndaj të burgosurve ofrohej nga staf i tjetër shëndetësor dhe vetëm në kushte të domosdoshmërisë thirrej ndihma urgjente mjekësore e Spitalit Krujë. Në këto raste, shoqërimi për në spital, bëhej nga autoambulanca e institucionit.

Në ambientin spitalit të IEVP-së, gjendej dhoma e vizitave të mjekut, dhoma e stomatologut, si dhe farmacia e institucionit. Dhoma e stomatologut ishte e pajisur me karrige, sterilizues, si dhe njësinë dentare të cilat ishin funksionale, sipas kërkesave të të burgosurve për vizitë apo kontroll mjeksor. Por, nga ana e disa të burgosurve kishte ankesa në drejtim të ofrimit të shërbimit stomatologjik, përsa i takon ndërhyrjeve kirurgjikale dhe mbushjeve, të cilat nuk mund të kryheshin nga stomatologu i institucionit dhe duhet të kryheshin në klinikat private me shpenzimet e tyre. Dhoma e mjekut, e stomatologut dhe farmacia ishin të lyera dhe në kushte të mira higjieno-sanitare.

Në intervistat e zhvilluara me të burgosurit, u paraqitën ankesa se gjatë periudhës së pandemisë dhe kohës të zhvillimit të inspektimit, ka patur vonesa në kryerjen e vizitave mjeksore te mjekët specialistë të spitaleve, sa për shkak të kufizimit të lëvizjeve dhe kontaktit me botën jashtëme, po aq dhe për mungesë të rekomandimit nga mjeku i institucionit.

Në vlerësimin e MKPT-së, kjo përbën mohim të të drejtës për të marrë shërbim mjeksor të specializuar në spitale të të burgosurve, të sëmurëve kronikë apo atyre që paraqesin shqetësime shëndetësore. Gjithashtu, kjo përbën edhe shkelje të standardit të përcaktuar në Rregulloren Evropiane të Burgjeve ku thuhet shprehimisht se: *“Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë në kujdesin e tyre. Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit. Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore, kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në komunitet”*¹⁰.

Në kushtet mungesës të mjekut, personeli i infermierëve që jepnin terapinë e të sëmurëve kronikë dhe atyre akutë, ndiqnin procedurën sipas protokollit shëndetësor dhe njëkohësisht të masave të sigurisë në burgje, duke qënë vetë prezent në momentin e marrjes së terapisë dhe mos lënien e medikamenteve në dhomat e tyre.

Në momentin e inspektimit, nisur nga diagnostikimi i stafit shëndetësor të institucionit në bashkëpunim me mjekët e spitalit rajonal Krujë të burgosurve që kishin paraqitur shqetësimime shëndetësore, ishin evidentuar dhe po trajtoheshin 29 persona me probleme të shëndetit mendor. Këta persona ishin akomoduar në Sektorin e Kujdesit të Veçante (SKV) të krijuar enkas për këta persona.

¹⁰ Rregullorja Evropiane e Burgjeve, pika 39, 40.1, 40.5;

Theksojme se, të burgosurit me probleme të shëndetit mendor mbaheshin nën kontroll nga nga mjekët psikiatër që vinin sipas grafikut nga Spitali i Burgjeve në Tiranë. Ndërsa, personeli i infermierëve të institucionit, u jep terapinë këtyre shtetasve sipas rekomandimeve të lëna nga mjekët psikiatër, duke qenë prezent në momentin e marrjes së terapisë dhe mbikqyrnin me rigorozitet administrimin e tyre.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor, e në veçanti të mjekut, u konstatua se kartelat klinike mbaheshin në dollap në dhomën e mjekut. Gjithashtu u këqyren regjistri i vizitave të mjekut, regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve, të cilat ishin mbajtur me rregull.

Gjatë intervistave me të burgosurit, u konstatuan ankesa në lidhje me realizimin e konsultave jashtë institucionit, sidomos të atyre rasteve që kur kishin kryer një ndërhyrje kirurgjikale dhe që nevojitej konsulta një herë në muaj sipas rekomandimit të mjekut specialistë. Ankesat lidheshin edhe me shërbimin stomatologjik të institucionit, për mungesë shërbimi sa i përket ndërhyrjeve kirurgjikale ashtu dhe ekstraksioneve, si dhe pamundësisë të të burgosurve për ti shoqëruar në klinikat private, për shkak të kufizimeve të lëvizjeve jashtë ambientit të burgjeve, si rezultat i situatës të emergjencës shëndetësore aktuale.

Theksojmë se, institucioni ishte i furnizuar me sasinë e nevojshme të medikamenteve të urgjencës, por dhe për të sëmurët kronikë, të cilat shpërndareshin nga stafi shëndetësor i infermierëve, sipas rekomandimit të mjekëve specialist. Gjithashtu, të burgosurit ishin të pajisur me librezat shëndetësore, e cila e shoqëronte çdo të burgosur gjatë transferimeve nga njëra IEVP në tjetrën.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe, në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, ku parashikohet midis të tjerash se: *“Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues”*:

REKOMANDOJMË:

1. Të merren masat e nevojshme për adresimin e situatës së mbipopullimit dhe përcaktimin e saktë të kapacitetit fizik të IEVP Fushë-Krujë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore të miratuar, duke marrë në konsideratë standartin ndërkombëtar të pranuar tashmë, që çdo qeli të ofrojë minimalisht 4m² hapësire jetike për person.
2. Marrjen e masave të menjëhershme, për ndërprerjen e përdorimit të ambienteve të veçimit dhe të observimit, për akomodimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve në

këto ambiente për periudha të gjata kohore, tej afateve të parashikuar në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, nga Komisioni i Pritjes dhe Komisioni i Disiplinës, që nuk janë subjekt i tyre.

3. Të merren masa të menjëhershme për sigurimin e mjekut me kohë të plotë në institucion dhe të vihet në dispozicion mjeku psikiatër, për të kryer vlerësime psikiatrike më të shpeshta, për të burgosurit në veçanti për të sëmurët me probleme të shëndetit mendor, duke siguruar një sistem efektiv të rekomandimeve për pacientët e sëmurë kronikë, por dhe jo vetëm.
4. Të merren masa për shtimin e kompjuterave në ambientin e takimeve, me qëllim komunikimin online të të burgosurve me familjet e tyre, sipas kapacitetit të popullimit që ka secila IEVP.
5. Marrjen e masave të nevojshme, lidhur me përmirësimin e situatës të furnizimit me ujë të ambienteve në regjimin e brendshëm të institucionit, duke gjetur mënyra alternative të furnizimit me ujë ose duke shtuar orët e grafikut të lejimit ujit për mbajtjen e higjienës personale të burgosurve, pastërtinë e dhomave të banimit e ambienteve të përbashkëta, si dhe për furnizimin me ujë të pijshëm.
6. Të marren masa të nevojshme, për rregullimin dhe vënien në përdorim të kaldajës qendrore dhe sistemit ngrohje/ftohje për ambientet në regjimin e brendshëm, sipas kushteve klimaterike.
7. Të merren masa të menjëhershme për adresimin e situatës së mungesës së energjisë elektrike, sigurimin e fondeve për lidhjen e linjës së brendshme të institucionit me linjën e jashtme të furnizimit 20 KË, si dhe për riparimin e rrjetit të brendshëm elektrik, kryesisht në dhomat e banimit dhe ambientet e dusheve.
8. Marrjen e masave të menjëhershme, për mundësimin e të burgosurve për larjen e trupit në dushe me ujë të ngrohtë, sipas rregullores, por edhe sipas nevojave të tyre.
9. Marrjen e masave të nevojshme, për hidroizolimimin e tarracave të godinave të banimit në regjimin e brendshëm, si dhe eliminimin e lagështirës në ambientet e dhomave të banimit dhe të dusheve.
10. Të marren masat e menjëhershme për sigurimin orendive shtesë si karrige, komodina dhe rafte në dhomat e banimit, kryesisht për ato dhomat ku janë akomoduar 4 dhe 6 persona.
11. Të merren masa e nevojshme, pas lehtësimit të masave kufizuese për shkak të emergjencës shëndetësore, për të mbajtur aktive kurset arsimore për zhvillimin e arsimit 9-vjeçar dhe ushtrimin në kurset profesionale në bashkëpunim me Zyrën Arsimore dhe QFP Krujë, si dhe në hartimin e programeve të përbashkëta rehabilituese për të burgosurit.
12. Të merren masa të menjëhershme për shtimin e aktiviteteve integruese dhe social-kulturore, me të dënuarit dhe të paraburgosurit në përgjithësi dhe në veçanti për grupmoshat 18-21 vjeç.
13. Të merren masat e menjëhershme për pasurimin e bibliotekës me libra të rinj dhe rritjen e interesit të të burgosurve për leximin.

14. Të merren masa për dezinfektimin dhe higjienizimin e dhomave të banimit, ambienteve të dusheve, ambienteve të jashtme, kuzhinës dhe magazinës së ushqimeve në mënyrë periodike, për shkak të vijimit të masave anti COVID-19.
15. Të merren masa nga ana e stafit të sektorit shëndetësor, për t'ju përgjigjur në kohë të kërkesave të të dënuarve, në lidhje me vizitat mjekësore, si dhe konsultat e specializuara në qendrat spitalore.
16. Të merren masa për ofrimin e një shërbimi efikas stomatologjik me ndërhyrjet përkatëse, mbushje apo ekstraksione, duke qenë se nuk mungonin materialet dhe instrumentet dentare në dhomën e stomatologut.
17. Stafit shëndetësor në DPB të rishikojë në varësi të dinamikës të situatës epidemiologjike nga virusi COVID-19, kufizimin e periudhës së karantinës për shkak të vizitave dhe konsultave mjekësore të pacientëve pranë mjekëve në spitalet rajonale, duke ulur karantinën nga 14 ditë në 10 ditë.
18. Marrjen e masave të menjëhershme për zëvendësimin e enëve të vjetëruara të kuzhinës që shpërbejnë për shpërndarjen e ushqimit të burgosurve, me enë të reja.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

Ermonela XHAFA